

Z. Ndue Përdoçi

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të regjistruar me nr. 1274 prot, datë 06.02.2024, ju informojmë se:

Referuar Vendimit të Këshillit Administrativ të ISSH nr.12, datë 29.06.2016 “Për miratimin e rregullores “Për llogaritjen dhe procedurën e indeksimit të bazës së vlerësuar për efekt të përfitimeve”, kapitullit III, pika 1/b, 2/a, 2/b përcaktohet se:

1/b. Baza e vlerësuar për periudhën e përfitimit të papunësisë është shuma e pagave minimale mbi të cilën janë paguar kontributet nga buxheti i shtetit, për periudhën e përfitimit të trajtimit me pagesë papunësie, të indeksuara me koeficientët përkatës sipas viteve.

Baza e vlerësuar për pagesën e papunësisë para datës 01.01.1994, është shuma e pagave referuese të caktuar në tabelën A3, numri rendor 33 “punëtor të tjerë” e cila është 2,685 lekë e indeksuar me koeficientin përkatës sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave.

2/a. Baza e vlerësuar për periudhën gjatë së cilës personi ka kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak kur personi ka qenë në marrëdhënie pune, do të jetë paga referuese e llojit të punës në momentin e fillimit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak e përcaktuar në tabelat A1,A2,A3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.561, datë 12.08.2005, e indeksuar me koeficientin përkatës sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur para fillimit të shërbimit të detyrueshëm shtarak, personi nuk ka punuar apo ka qenë anëtar i kooperativës bujqësore, për shkak se periudha e shërbimit të detyrueshëm është njohur si vjetërsi në marrëdhënie pune me shtetin, si page referuese meret paga e caktuar në tabelën A3, numri rendor 33 “punëtor të tjerë” e cila është 2,685 lekë e indeksuar me koeficientin përkatës sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave.

2/b. Baza e vlerësuar për periudhën e qënies si anëtar i kooperativës bujqësore do të jetë paga referuese e përcaktuar në masën 1,619 lekë në muaj, për 19,16 ditë pune të kryera nga

gratë dhe 23,33 ditë pune të kryera nga burrat e indeksuar me koeficientin përkatës sipas viteve.

Përsa i përket pyetjes, nëse kontributet e paguara në emrin tuaj për periudhën 2019 – 2022 nga subjektet Teta Albania dhe Xhast sh.p.k, mund të transferohen në periudhën para vitit 2014, për të cilën ju jeni i pasiguruar, sqarojmë se:

Në VKM 77, datë 28.01.2015, Kapitullin I, "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor" i ndryshuar, janë të përcaktuara kategoritë e personave të mbrojtur dhe të detyruar për t'u siguruar, dhe sipas pikës 1/gj, përfshihen edhe personat e punësuar në dy ose më shumë subjekte juridike ose fizike, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, për degën e sigurimit të sëmundjeve, barrëlindjes, pensioneve, aksidenteve në punë e sëmundjeve profesionale, papunësisë dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor.

Sipas VKM së sipërcituar, llogaritja e kontributit të sigurimit shoqëror dhe sigurimit të kujdesit shëndetësor është e detyrueshme për çdo subjekt. Në këtë rast, llogaritja e kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor bëhet sipas pagës përkatëse, që merr nga secili subjekt, ndërsa masa e llogaritur e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në total, të jetë jo më shumë se kontributi i llogaritur mbi pagën maksimale;

Për sa më sipër, ju bëjme me dije se, kontributet e paguara për periudhën 2019 - 2022, nga subjektet Teta Albania dhe Xhast sh.p.k nuk mund të transferohen për periudhën para vitit 2014, pasi kontributet janë të detyrueshme për t'u paguar kur i njëjti person është ekonomikisht aktiv në dy ose më shumë subjekte dhe në secilin prej tyre merr pagë.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.